

## VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË

NR. 2492 DATË 12 104/2023

Sot, më datë 12 Prill 2023, UKR, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT L63327402A mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Lila Hoxha për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

### Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

### Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria UKR.SHA nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 1363 Rep. dhe Nr. 621 Kol, datë 07/10/2022 midis shoqërisë UKR dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Fier sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijnë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

### Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Zj. Edlira TORO si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguria se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

MAJLINDA BUFI

